



**Koalicioni i
Vëzhguesve
Vendorë**

2011

KODI I ETIKËS

dhe

PARIMET BAZË TË PUNËS SË VËZHGUESIT VENDOR

**Tiranë
2011**

Përgatitur nga:



INSIZ-Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve

AIESD-Albanian Institute for Election System Development

@ INSIZ

Arti Grafik: geavisual.com
Shtypur në Shtypshkronjën "Ekspres"
Rr"Samë Frashëri". Nr.15
Tiranë-Albania

PARIMET BAZË TË ETIKËS dhe PUNËS SË VËZHGUESIT VENDOR

Në kuptim të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë

Termi "*vëzhgim i procesit zgjedhor*" nënkupton :

(i) Grumbullimin e informacionit që përshkruan ecurinë e zbatimit të kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi sipas së cilit duhet të kryhen veprimet e njëpasnjëshme në një proces zgjedhor.

(ii) Përpunimin e këtij informacioni dhe dhënien e gjykimeve, pa ndërhyrë në punën dhe aktivitetin e komisioneve të zgjedhjeve, të çfarëdo niveli.

Termi "*Vëzhgues*" mund të përdoret në disa kuptime :

(i) Individ që është i ngarkuar për të vrojtuar se si zbatohen kërkesat e ligjit nga stafet e ndryshme përgjegjëse për administrimin e procesit zgjedhor dhe/ose situatat dhe rregullsitë sipas të cilave kryhen procedurat e ndryshme të procesit zgjedhor – fushata elektorale, regjistrimi i subjekteve, listat e votuesve, pasqyrimi në media elektronike e të shkruar, procesi i votimit, numërimi i votave etj.

(ii) Organizatë e cila merr përsipër të vrojtojë aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor dhe që do të komunikojë konstatimet, gjykimet dhe përfundimet nëpërmjet përfaqësve të saj dhe/ose vëzhguesve duke përdorur forma të ndryshme komunikimi si : deklarata për shtyp, informacione dhe raporte. Mbështetur në përvojën dhe mbi bazën e përfundimeve të rrjedhura prej informacionit që ajo grumbullon gjatë vëzhgimeve, bën propozime për përmirësime të mëtejshme të ligjit dhe rregullave nënligjore që hartohen në zbatim të tij.

(iii) Grup organizatash që, së bashku, sipas një metodologjie të pranuar prej tyre, do të vrojtojnë aspekte të caktuara, specifike, të procesit zgjedhor.

(iv) Vëzhgues afat-shkurtër dhe vëzhgues afat-gjatë, në varësi të kohëzgjatjes, aspektit (aspekteve) të procesit zgjedhor që do të vrojtojë.

Parimet bazë të **ETIKËS** dhe **PROFESIONALE** mbi të cilat duhet të mbështetet puna e një vëzhguesi

1.Vëzhguesi i zgjedhjeve duhet që në çdo kohë dhe situatë të respektojë dhe të zbatojë kërkesat e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe gjithë udhëzimet e KQZ-së dhe komisioneve të tjera zgjedhore.

- Në respektim të ligjit, vëzhguesi duhet të paraqesë përpara çdo komisioni zgjedhor autorizimin e lëshuar nga KQZ si dhe dokumentin personal të identifikimit. Në çdo rast, rekomandohet që ai t'i shpjegojë, shkurt dhe qartë, komisionit të zgjedhjeve aspektet e procesit zgjedhor që do të vëzhgojë.
- Vëzhguesi duhet të njohë dhe të respektojë rolin, statusin dhe autoritetin e komisionit zgjedhor. Në çdo rast ai duhet të mirëkuptohet dhe të bashkëpunojë me këtë komision, pa ndërhyrë në punën e tij.
- Vëzhguesi duhet të respektojë çdo votues që paraqitet para komisionit zgjedhor, të dëgjojë dhe mbajë shënim ankesat e tyre
- Vëzhguesi duhet t'i japë komisionit të zgjedhjeve kopje të informacionit të shkruar ose deklarimeve që dëshiron të kryejë. Ai duhet të jetë veçanërisht i kujdesshëm në ato deklarime të cilat mund të ndikojnë direkt në punën e komisionit.
- Vëzhguesi duhet t'i shmanget interpretimit të kërkesave të kuadrit ligjor. Kjo është një e drejtë vetëm e komisionit.

2.Vëzhguesi i zgjedhjeve, gjatë të gjithë aktivitetit të tij, duhet të jetë objektiv, i pavarur dhe të mos mbështesë ose përkrahë asnjë subjekt zgjedhor konkures.

- Roli themelor i vëzhguesit është mbështetja e legjitimitetit të një procesi zgjedhor, ose aspekteve të veçanta të tij, dhe kundërshtimi i çdo veprimi që bie ndesh me kuadrin ligjor në fuqi, me pasoja deligjitimitimin e procesit zgjedhor. Aftësia e tij për të plotësuar këtë rol kushtëzohet thelbësisht prej të qenit rigorozisht i paanshëm dhe politikisht neutral.
- Vëzhguesi duhet t'i shmanget shfaqjes së çdo preference politike dhe nuk duhet të kryejë asnjë veprim që mund të interpretohet si mbështetës për një koalicion, kandidatë në listë ose subjekt tjetër zgjedhor.
- Vëzhguesi nuk duhet të pranojë asnjë dhuratë ose favor që mund t'i bëhet nga ndonjë parti politike, koalicion, organizatë ose individ i përfshirë në garën elektorale.

- Vëzhguesi nuk duhet të marrë pjesë në ndonjë aktivitet ose të pranojë funksione që mund të interpretohen si shfaqje të simpatisë ndaj një subjekti zgjedhor.
- Vëzhguesi nuk duhet të shprehë pikpamje të tijat në lidhje me ndonjë subjekt zgjedhor dhe nuk duhet të komunikojë me votuesit për çështje që lidhen me garën elektorale.
- Vëzhguesi nuk duhet të veshë ose mbajë simbole që propagandojnë parti ose subjekte të tjera elektorale.

3.Vëzhguesi i zgjedhjeve duhet të jetë sa më i përgatitur dhe profesional në dhënien e gjykimeve për aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor të vrojtuar prej tij. Profesionalizmi në gjykim, nëpërmjet vlerësimit të efekteve të faktorëve që ndikojnë në një proces zgjedhor, është baza për të pranuar ose jo përfundimet e një vëzhgimi

Për të bërë të mundur realizimin e kësaj kërkesë vëzhguesi duhet të përqëndrojë vëmendjen, veçanërisht, në faktorët e mëposhtëm:

- Shkallën e paanshmërisë dhe nivelin e cilesinë profesionale në zbatimin e ligjit prej komisioneve të zgjedhjeve, në të gjithë aktivitetin e tyre.
- Mundësitë e krijuara për koalicionet, partitë dhe subjektet e tjera elektorale për të zhvilluar fushatën elektorale.
- Vëzhguesi duhet të vlerësojë:
 - (i) shkallën e respektimit të lirisë së shprehjes, organizimit të mbledhjeve dhe mitingjeve elektorale;
 - (ii) nivelin e barazisë midis subjekteve të ndryshme elektorale për të vrojtuar të gjitha aspektet e procesit elektoral;
 - (iii) realizimin për to, të të drejtave të barabarta dhe në përputhje me ligjin, në përdorimin e medias dhe burimeve të tjera të informimit;
 - (iv) sigurimin e mundësive të barabarta për të votuar për të gjithë votuesit me të drejtë vote;
 - (v) nivelin e realizimit të të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e grave, që janë të lidhura me mundësitë e zgjedhësve për të marrë pjesë në procesin e zgjedhor;
 - (vi) çdo problem që është i lidhur dhe kushtëzon zhvillimin e proceseve zgjedhore të lira e të ndershme.
- Vëzhguesi duhet të vlerësojë nivelin e plotësisht të kërkesave të ligjit për procesin e votimit dhe të numërimit të votave.
- Vëzhguesi duhet të bëjë përpjekje që:
 - (i) të krijojë një përfytyrim sa më të plotë dhe të saktë për të gjithë aspektet e procesit zgjedhor dhe kuadrin ligjor e

- nënligjor që rregullon ecurinë e tyre, me qëllim që të mund të gjykojë për nivelin e legjitimitetit të tyre;
- (ii) të vëzhgojë dhe të grumbullojë informacion me anë të të cilit të mund të gjykojë se në çfarë niveli administrata e zgjedhjeve zbaton kërkesat e ligjit dhe mundëson realizimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme;
 - (iii) të vëzhgojë nivelin e pjesëmarrjes së grave në procesin elektorale;
 - (iv) të gjykojë nëse listat e zgjedhësve janë të sakta dhe nëse regjistrimi i koalicioneve, partive politike dhe kandidatëve të pavarur bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit;
 - (v) të grumbullojë informacion për të gjykuar në lidhje me nivelin e informimit të zgjedhësve dhe sa ata i njohin kërkesat e ligjit dhe rregullat që duhet të respektojnë gjatë procesit të votimit;
 - (vi) të arrijë të gjykojë se sa efektive janë masat e marra për parandalimin e votimit më shumë se një herë dhe sigurinë e sekretit dhe fshehtësisë së votës.

4. Vëzhguesi i zgjedhjeve duhet të jetë sa më transparent në dhënien e informacionit dhe gjykimet të tij.

- Organizata ose grupimet e organizatave që marrin përsipër të vëzhgojnë procesin zgjedhor duhet të përpunojnë metoda punë dhe mënyra komunikimi sa më transparente dhe të mundshme për akses. Ato duhet të bëjnë sa më të njohura:
 - (i) Metodologjinë e punës së tyre, tipin e të dhënave që do të grumbullojnë dhe mënyrën e analizimit të tyre. Në veçanti, ky informacion është i domosdoshëm të jepet në raportin që ato do të paraqesin.
 - (ii) Objektivat e vëzhgimit.
 - (iii) Kur raportin të dhëna statistikore, duhet të bëjë të njohur mënyrën dhe metodën e zbatuar për grumbullimin e informacionit dhe të japë, në çdo rast, edhe nivelin e pasaktësisë që i shoqëron këto statistika.
- Vëzhguesi duhet të informojë, me shkrim, komisionin e zgjedhjeve për të metat që vëren në procesin zgjedhor, me qëllim që ky komision të marrë masat për ndreqjen e tyre.
- Mbështetur në vëzhgimet e kryera prej vëzhguesve të aktivizuar prej saj (tyre), organizata (grup organizatat) komunikojnë direkt, nëpërmjet

organizimit të konferencave për shtyp dhe raporteve pjesore ose përfundimtare, përfundimet e dala nga procesi i vëzhgimit

5. Vëzhguesi i zgjedhjeve duhet të japë informacion sa më të saktë.

- Vëzhguesi (organizata) duhet të hartojë raportin e tij vetëm mbi bazën e një informacioni të saktë, të besueshëm dhe të mundshëm për konsultim dhe përdorim edhe nga të tjerët.
- Informacioni që do të përdorë vëzhguesi (organizata) duhet të jetë i saktë dhe, mundësisht, i verifikueshëm. Grumbullimi, përpunimi dhe publikimi i tij duhet të bëhet në mënyre të tilla që, për këdo të interesuar, të jete sa më i qartë, të mos krijojë mundësi për interpretim dhe të jete jo i dyshimtë.
- Informacioni duhet të jetë rezultat i vërtetimit të kryera prej vetë vëzhguesit dhe, në asnjë rast, nuk duhet të përdoret informacion i marrë nga burime dytësore.

6. Vëzhguesi duhet të plotësojë dhe respektojë kërkesat e organizatës që e aktivizon

- Çdo organizatë që merr përsiper të vëzhgojë procesin zgjedhor duhet të marrë të gjitha masat që vëzhguesit që ajo do të aktivizojë, të plotësojnë kushtet si më poshtë:
 - (i) Çdo vëzhgues duhet të jetë i gatshëm të informojë organizatën që e aktivizon për çdo problem që mund të vështirësojë plotësimin e misionit që do t'i ngarkohet, si p.sh.:
 - (a) Të informojë për gjëndjen shëndetsore dhe mundësitë fizike të tij për plotësimin e detyrës që do t'i ngarkohet;
 - (b) Të informojë për çdo problem personal, aktual a të kohëve të shkuara, në rast se ai krijon konflikt me detyrën e vëzhguesit të zgjedhjeve.
 - (ii) Gjatë misionit të tij, vëzhguesi duhet të bëjë përpjekje maksimale për të siguruar dhe plotësuar të gjitha interesat e organizatës që e ka aktivizuar.
 - (iii) Gjatë gjithë kohës kur vëzhguesi është në kryerje të detyrës si edhe në intervalet ndërmjetëse, në jetën e tij personale, duhet të prezantojë një figurë të plote qytetare.
 - (iv) Çdo vëzhgues duhet të respektojë e të bashkëpunojë me të gjithë vëzhguesit e organizatave të tjera vendore dhe/ose të huaj.

- (v) Vëzhguesi nuk duhet të marrë pjesë në asnjë aktivitet të paautorizuar, përfshirë këtu edhe aktivitete që mund të konsiderohen private, por që mund të krijojnë kushtë për konflikt interesash me cilësinë e tij si vëzhgues i zgjedhjeve.
- (vi) Vëzhguesi nuk duhet të bëjë asnjë koment publik pa qënë i autorizuar
- (vii) Çdo vëzhgues duhet të raportojë në organet dhe personat e autorizuar prej organizatës për çdo incident ose problem që ai vlereson se mund të ndikojë negativisht në mbarevajtjen e punës së organizatës.
- (viii) Vëzhguesi, në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk mund të mbajë më vetë armë.

KUJTESË
për
Kodin e Sjelljes së Mirë për Vëzhguesit e Koalicionit të Vëzhguesve
Vendorë

Vëzhguesit e Koalicionit Shqiptar të Vëzhguesve Vendorë, gjatë zbatimit të detyrave të tyre. përveç kërkesave të *Kodit të Etikës dhe Profesional* duhet të respektojnë edhe **Kodin e Sjelljes së Mirë**

VËZHGUES!

Kujto se Kodi i Sjelljes së Mirë kërkon që :

1. Të mbash një qëndrim jopartizan gjatë gjithë kohës. Nuk duhet që në asnjë moment të shprehësh ndonjë preferencë në lidhje me subjektet zgjedhore, koalicionet, partitë, kandidatët, apo gjithçka që ka lidhje me procesin zgjedhor.
2. Të realizosh detyrën tënde pa ndërhyre në procesin zgjedhor, pa komentuar dhe ndërhyre në punën e komisionit zgjedhor, në procedurat e ditës së votimit dhe numërimit të votave.
3. Të mbash me vete dokumentin e identifikimit dhe Karten e akreditimit të dhënë nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve. Paraqitja këto dokumenta KQV-së dhe /ose KZAZ-së.
4. Të mos veshësh apo mbash simbole që manifestojnë preferenca politike.
5. Mund të sjellësh në vëmendjen e KQV-së dhe /ose KZAZ-së parregullsi të ndryshme të vëzhguara, por nuk mund të japësh udhëzime ose të kundërshtosh vendimet e komisionereve.
6. Përfundimet dhe komentet e tua duhet t'i bazosh mbi fakte të dokumentuara dhe të dhëna të verifikueshme.
7. Mos bëj asnjë koment personal apo paraprak rreth vëzhgimit të kryer, edhe kur këta ta kërkojnë përfaqesues të medias apo ndonjë person tjetër i interesuar.
8. Të njoftosh drejtuesit e tu, koorinatorin në rajon dhe në Qendrën e Koordinimit të Koalicionit, në Tiranë, në kohë reale, për çdo parregullsi që vëzhgon

9. Në të gjithë aktivitetin tënd të zbatosh kërkesat e Kodit të Etikës së Vëzhguesit dhe të respektosh Kodin Zgjedhor dhe gjithë udhezimet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve